



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Idriz Vehapi, Kryetar i Komunës së Rahovecit Nahit Elshani, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 11/05/2017 Nr. 020-719
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 1429 për miratimin e raportit vjetor për vitin 2016 të Komitetit për Shërbime Publike
I miratuar më datë: 28.04.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.05.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Idriz Vehapi, gradonačelnik opštine Orahovac Nahit Elshani, predsedavajući Skupštine opštine Orahovac
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, per. [signature] Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a
Od:	Shkelqim Jakupi, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i [signature] nadgledanje opština, MALS
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Orahovac
Vrsta akta:	Odluka

Dana: 11.05.2017.
Br. 020-719

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.1429 za usvajanje godišnjeg izveštaja odbora za javne usluge, za 2016. godinu.
Usvojena dana: 28.04.2017. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 10.05.2017. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

HYRESE-ULATNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarsivo Lokalne Samouprave Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum Date	10.05.2017		
Ajenti organizivak	Nr. i Lendes	Smerja	Vlera
-2-	920-719		



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 12.1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2017, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RAPORTIT VJETOR (PËR VITIN 2016) TË KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

- I. **Aprovohet:** Raporti Vjetor i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2016.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike.
- III. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web - faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

Nr. 1429
Rahovec, 28.04.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 1429 Më 28.04 2017
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal / Skupština Opštine / Municipal Rahovec

Na osnovu člana 12.1, člana 17. Zakona za Lokalnu Samoupravu Kosova br. 03/L-040, člana 40. i člana 57. stav 1. tačka 1.6 Statuta Opštine Orahovac Br 1005 od 29.03.2017. godine, Skupština Opštine na svojoj održanoj sednici 28.04.2017. godine, donosi:

ODLUKU

ZA USVAJANJE GODIŠNJEG IZVEŠTAJA KOMITETA ZA JAVNE USLUGE ZA 2016. GODINU

- I. Usvaja se: Godišnji Izveštaj o Radu Komiteta za Javne Usluge za 2016. godinu
- II. Za sprovođenje ove odluke stara će se Predsedavajući Skupštine.
- III. Nakon usvajanja od strane Skupštine Opštine, ova odluka stupa na snagu 15. dana nakon upisa u kancelariji za protokol u Ministarstvu Administracije Lokalne Samouprave, kao i nakon objave na službenim jezicima na zvaničnoj Internet Stranici Opštine Orahovac.

SKUPŠTINA OPŠTINE ORAHOVAC

Br. 1429
Orahovac, 28.04.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 1429 Mb 28.04.2017
Br. prot. Dt. 28.04.2017
RAHOVEC - ORAHOVAC

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO REJVAH E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarsivo Lokalne Samouprave / Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum Date	10.05.2017		
Niveli organizimi No. i llojit	SHKËRIM	VISTA	
-VI- 020-119			

P



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Për: Kuvendin e Komunës së Rahovecit

RAPORTI VJETOR (PËR VITIN 2016) I KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

Ne si Komitet i Shërbimeve publike në vitin 2016, (për shkak të rrethanave të krijuara me kryesuesin paraprak, dhe vonesës në kompletimin e komitetit), i kemi mbajtur dy mbledhje.

Mbledhjen e parë e kemi mbajtur me 23.03.2016 me këtë rend dite:

1. Informate fillestare për punën e komitetit në të kaluarën,
2. Informatë mbi ndriçimin publik,
3. Informatë mbi problemin me qentë endacak
4. Informatë mbi furnizimin me ujë të pijshëm.
5. Të ndryshme.

Mbledhjen e dytë e kemi mbajtur me datën 07.10.2016 me këtë rend dite:

1. Informatë mbi realizimin e planit të mirëmbajtjes së rrugëve në sezonin e kaluar dimëror.
2. Informatë mbi planin për mirëmbajtjen e hapësirave publike, rrugëve dhe trotuareve.
3. Informatë mbi planin e menagjimit të mbeturinave.

Por në këtë raport jam munduar që përveç informatave zyrtare nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ti marrë edhe informatat, dhe shqetësimet edhe nga terreni për çka i kam vizituar shumicën e fshatrave sidomos ato ku kam konsideruar që ka shqetësime më të mëdha. Kjo nuk e zbeh aspak punën e mirë që e ka bërë qeveria komunale por ka edhe mjaft nevoja dhe kërkesa, e që jemi munduar ti evidencojmë në terren.

Furnizimi me ujë të pijes

Shumica e fshatrave të komunës tonë problemin e ujit të pijes e kanë të zgjidhur, por janë edhe disa fshatra që ende ballafaqohen me këtë problem. Gjendja më e keqe qëndron në fshatrat Guri i kuq, Palluzhë, Kaznik, Pastasel, Mrasor si dhe gjatë stinës së verës edhe në Drenoc ka reduktime të mëdha.

Në fshatin Guri i kuq, rrjeti është i shpërndarë por problemi qëndron te gypi kryesor të cilit duhet të ndërrohet kahja pasi është vendosur nëpër pronë private të një banori i cili nuk e lejon një gjë të tillë.

Në Palluzhë, Rrjeti është shpërndarë në rreth 70% të fshatit, dy lagje nuk kanë qenë të përfshira në rrjet por edhe ato sivjet po kompletohen. Siç u cek edhe më lartë pengesa kryesore ka qenë gypi kryesor në Gurin e kuq, si dhe kualiteti i dobët i gypit që vjen prej Qifllakut e i cili duhet të zëvendësohet komplet.

Në Kaznik, gjendja është gjithashtu tejet e rëndë, dhe zgjidhja më e lehtë është ndërtimi i një rezervuari pasi që bjeshka ka ujë të mjaftueshëm.

Në Pastasel, gjithashtu gjendja është e keqe pasi që shpuarjet që janë bërë në mandatin e kaluar nuk funksionojnë fare. Rrjeti është shpërndarë mirëpo sikur edhe në fshatrat e cekura më lartë, edhe ky fshat e pret zgjidhjen e problemit të gypit kryesor në Gurin e Kuq.

Në Mrasor, Nuk ka furnizim as rrjet të instaluar dhe me ujë furnizohen prej puseve . Kërkesën ja kanë parashtruar edhe Komunës, edhe Radoniqit, arsyetimi i Radoniqit është se ne vetëm e presim një kërkesë zyrtare nga Komuna dhe ne do ta përkrahim. Pra mbetet që të koordinohet Komuna me Radoniqin dhe të lëvizet diçka në këtë drejtim.

Në Drenoc, Furnizimi bëhet prej një shpuarje, e cila as 70% nuk i plotëson nevojat e qytetarëve. Kanë bërë kërkesë në Radoniq edhe për një shpuarje. Reduktimet në sezonin veror janë te tmerrshme, (vetëm 6 orë me ujë).

Ne fshatrat tjera furnizimi është i rregullt përveç që në disa lagje të epërme gjatë verës nuk ka shtypje të mjaftueshme, si psh. në Krushe (lagja Duraku dhe e minoriteteve), Ne Rahovec lagja nr.3, në Brestoc, etj.

Ujrat fekale (Kanalizimi)

Me kanalizim shumica e fshatrave kanë problem qoftë me mungesën e rrjetit qoftë me mosfunksionim dhe defekte. Psh.

Në Senovc vetëm 30% janë të mbuluara me kanalizim ndërsa pjesa tjetër është në gjendje katastrofale.

Në Drenoc 80% e fshatit është e kyçur por kanalizimi nuk funksionon si duhet.

Në Pastasel 80% e fshatit është e kyçur në rrjet dhe funksionon mire, përveç një lagje që ende nuk është përfshirë fare në rrjet.

Në Palluzhë, kanalizimi është funksional por mungon gropa septike në fund të fshatit.

Në Kaznik nuk ka fare kanalizim dhe krahas ujit të pijes do të duhej instaluar edhe kanalizimin sepse vërtet gjendja është e mjerueshme.

Në Kramovik rrjeti i kanalizimit është i shtrirë vetëm në 50% të fshatit, më problematike është gjendja në lagjet Kelmendi, Krasniqi dhe Morina.

Në Qifllak, rrjeti është shtrirë dhe funksionon mirë, përveç në lagjen e epërme (ana e djathtë e rrugës magjistrale Xërxe Kramovik) ku nuk ka fare rrjet të kanalizimit.

Në Dabidol, vetëm nja 10 familje që nuk kanë mundur me u kyç për shkak të konfiguracionit të terrenit.

Ne Guri të kuq, vetëm mungon gropa septike në fund të fshatit.

Në Mrasor, pa kanalizim ka mbetur vetëm edhe rreth 30% (pjesa e poshtme e fshatit). Është paraparë edhe ndërtimi I gropës septike por nuk është ndërtuar e çka është më shqetësuese në Komunë është ë raportuar si e ndërtuar.

Në Xërxe, është i kryer në rreth 70% të fshatit, tani është në proces të kryerjes së punimeve në lagjen "Rakita" në drejtim të Drinit. Por janë disa shtëpi për të cilat duhet projekt I veçantë – mbi firmën Xërxa.

Një shqetësim tjetër është se firma ELKOS e ka dëmtuar gypin e kolektorit kryesor të ujërave fekale dhe pothuajse në masë të madhe është i bllokuar.

Në Dejn, rreth 70% e fshatit është i kyçur në rrjet. Por rrjeti i ndërtuar menjëherë pas luftës nuk është sa duhet funksional, dhe për më keq dalja në fund është nëpër ara për shkak të mos funksionimit të gropës septike. Është e nevojshme ndërtimi edhe i rreth 300 m. kanalizim në pjesën veriore të fshatit Dejn e që do ta përfshinte edhe pjesën jugore të Dabidolit.

Në Ratkoc, rreth 70%, është e kryer, por lagjet që nuk kane ende kanalizim janë; Prej Xhamisë deri te Morina (Lutant), Rruga e Valakit deri te rruga e Biqecit, Lagja e Billallve (te varrezat), lagja e Sokolve, lagja e Bilallve përtej hekurudhës, si dhe lagja Shala në hymje të fshatit ana e majtë.

Në Malësi të vogël, kanë mbetur edhe rreth 30% pa u kyç si p.sh. Lagja e Lushve, Mertezve (Morina) dhe Mus Ahmetet).

Në Gexhe është i kyçur i ter fshati por për shkak të kryerjes së dobët të punimeve shpesh paraqiten probleme.

Në Hoqë të Vogël, në rrjetin e kanalizimit kanë mbetur pa u kyçur ende, lagjet Hoti (afër varrezave), Krasniqi (një pjesë) dhe disa shtepi të lagjes Katana.

Në Retije, Zaqisht dhe Apterushë kanalizimi është plotësisht funksionale, përveç që në Apterushë duhet të nxirren në sipërfaqe 27 shakta të cilat janë mbuluar gjatë rregullimit të rrugëve.

Në Sapniq, është rreth 70% e fshatit e përfshirë ne rrjet, por nuk është funksional sepse gypi kryesor është i bllokuar në disa vende.

Në Brestovc, edhe pse pjesa dërmuese është kryer nuk funksionon si duhet, por problem kryesor është kolektori që i lidh katër fshatrat. Kanë mbetur pa u kyçur edhe lagja në dalje kah Rahoveci.

Në Krushë të madhe duhet të shtrihet kanalizimi edhe në lagjen te shtallat (Duraku), Lagja te Zallinat, Duraku (në drejtim të Drinit).

Në Nagavc rrjeti është shtrirë individualisht pa kurrfarë kriteri dhe i tëri derdhet në lum çka është e pa tolerueshme. Në momentin që ndërtohet kolektori për 4 fshatrat atëherë duhet rishtas të rregullohet kanalizimi. Gjendjen e keqëson edhe me shumë derdhja e kanalizimeve në lum edhe e fshatrave Hoqë e vogël dhe Brestovc, krejt kjo për shkak të mungesës së Kolektorit kryesor.

Ne Celinë nuk janë të kyçur edhe rreth 30% e fshatit (pjesa e poshtme) afër magjistrales.

Në Pataqan te epërm rreth 50% e fshatit ende nuk është e mbuluar me rrjet të kanalizimit. Problem paraqet edhe derdhja e kanalizimit në fusha të hapura, çka e dëmton edhe ambientin edhe pronat bujqësore. Problem tjetër është se edhe aty ku ka kanalizim nuk ka mirëmbajtje dhe ka defekte të shumta, bllokim të kanalizimit, të pusetave, mungesa e kapakëve të pusetave etj.

Ujrat atmosferike

Në disa fshatra ujërat atmosferike paraqesin problem mjaft të madh si psh.

Në Qifllak, lagja e epërme mbi rrugën magjistrale, sa herë ka reshje atmosferike, shndërrohet në liqe prandaj kërkohet urgjentisht një urë në mes Qifllakut dhe Kramovikut për ta shpëtuar ketë lagje nga përmbytjet.

Në Dabidol gjithashtu ekziston i njëjti problem dhe nevojitet një kanal për shkarkimin e ujërave atmosferike deri në lumin Dri.

Në Malësi të Vogël, është i njëjti problem me lagjen mbi magjistrale.

Në Gexhe i njëjti problem, por i cili mund të zgjidhet më pastrimin e kanalit ekzistues prej rrugës magjistrale deri te hekurudha së paku një herë gjatë vitit.

Në Pastasel, në rrugën Milaim Krasniqi, sa herë ka të reshura prej ujit atmosferik bartet dheu dhe zbulohet gypi i kanalizimit prandaj duhet urgjent që ajo pjesë e rrugës të rregullohet dhe të mbulohet me kubeza.

Në Reti gjithashtu çdo herë prej reshjeve atmosferike mbushet kanali për kulimin e ujit në mes të fshatit.

Në Hoqë të vogël në lagjen e përbashkët Berisha dhe Gashi, ka nevojë për një kanal për kullimin e ujit atmosferik sepse po dëmtohet rruga e cila është e kubëzuar

Në Celinë gjithashtu prrocka e fshatit (në të cilën derdhet kanalizimi) shkakton problem të madh në lagjet e poshtme dhe sa herë mbushet kanali kthehet uji fekal nëpër familje duke ju shkaktuar dëme të konsiderueshme shumë familjeve.

Menagjimi i mbeturinave

Mbulueshmëria e vendbanimeve me mbledhjen e mbeturinave, në komunën tonë është 100%. Te gjitha fshatrat që i kam vizituar janë të kënaqur me kompanitë që i mbledhin mbeturinat, por problem më i madh qëndron te mos kyçja e familjeve e cila është shqetësim mjaft i madh sepse ato familje që nuk kyçen në kompani edhe e ndotin ambientin duke i hedhur mbeturinat vend e pa

vend. Gjendja më e keqe qëndron në Palluzhë (vetëm 20 familje janë të kyçura), në Kaznik, (vetëm 5 familje janë të kyçura), Në Malësi të vogël (50%), Në Dejn dhe Ratkoc (rreth 60% janë të kyçur), pastaj në Drenoc, Celinë etj. Në këtë drejtim duhet ndërmarr diçka qoftë përmes kushtëzimit me dokumente, qoftë me angazhim më të madh të inspektorëve të ambientit qoftë në drejtim të vetëdijesimit të banorëve.

Një shqetësim në lidhje me mbeturinat është shkarkimi i mbeturinave të lëngëta gjatë sezonit veror afër pusetave e të cilat pastaj kundërmojnë një kohe të gjatë (Xërxe dhe Retijë).

Mbeturinat e ngurta janë problem në vehte shumë i madh dhe jo vetëm në Rahovec, por ka vende që duhet intervenuar urgjentisht sikur rasti i Brestovcit e që mbeturinat që gjenden mbi ambulanten e fshatit duhet patjetër të zhvendosen në një lokacion tjetër.

Mirëmbajtja e hapësirave publike

Edhe pse numri i hapësirave të hapura publike në komunën tonë nuk është aq i madh, megjithatë edhe në ato lokalitete ku ka hapësira të hapura publike nuk janë aq të kënaqur me mirëmbajtjen dhe më tepër mirëmbahen prej komunitetit. Sidomos trotualet nuk mirëmbahen fare dhe ne shumicën e rasteve ose janë të dëmtuar, ose te mbuluar me baltë dhe bari si dhe me shkurre që e pengojnë lëvizjen e qytetarëve. Gjithashtu ka vërejtje në mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe lapidarëve.

Një shqetësim e kanë banorët e Krushës së madhe lidhur me bllokimin (uzurpimin) e trotuareve prej bizneseve dhe disa personave që me kamionë shesin thëngjill mu në hapësirën për lëvizjen e qytetarëve.

Realizimi i planit për mirëmbajtjen e rrugëve për sezonin (e kaluar) dimërorë dhe verorë

Sipas informative të drejtorit z. Muhamet Behra në sezonin e kaluar dimëror nuk kemi pasur problem, edhe aty ku janë paraqitur problemet janë evituar me kohë qoftë me hedhjen e kripës, qoftë me largimin e borës nga operatori i kontraktuar.

Në fshatrat Drenoc, Senoc dhe Pastasel, është një problem, sa herë ka të reshura të shiut, në disa vende mbushet me gurë dhe baltë rruga magjistrale dhe për disa ditë paraqet pengesë të madhe në qarkullimin e banorëve, prandaj kërkohet që pas reshjeve të pastrohet prej kompanisë për mirëmbajtjen e rrugëve.

Problemi me qentë endacak.

Sipas informatave nga drejtori i drejtorisë së Shërbimeve Publike në komunën tonë janë rreth 400 deri në 500 qen endacak. Në vitin 2015 i kemi ndarë 2000€ dhe me ato mjete janë trajtuar 34 qen. Për vitin 2016 janë planifikuar 5000€ në kodin për trajtimin e qenve mirëpo në vizitën që i kemi bërë në strehimore, me datën 29.10.2016 bashkë me Kadri Dellovën, pronari i strehimores na njoftoj se deri tani nuk kanë marrë asnjë cent. Ai na njoftoj se funksionon si biznes privat i regjistruar në komunën e Rahovecit.

Merret me shërimin, sterilizimin dhe kastrimin e qenve. Prej qershorit tha se janë trajtuar rreth 200 qen të Komunës së Rahovecit pa pagesë. Ndërsa qentë që janë të rrezikshëm ose të sëmurë, ndaj tyre zbatohet Eutonazia (vrasja humane) dhe varrosen mbi gropën special mbi Rahovec.

Ai na tha se hallka e informimit dhe e zbatimit të masave shkon prej komunitetit që duhet të drejtohen policisë, policia drejtorisë së inspektoriatit, inspektorët duhet të jenë prezent gjatë kapjes së qenve si dhe gjatë lëshuarjes së qenve në vendin ku janë marr. Një trajtim kushton 74€ (duke përfshirë kapjen, vaksinimin kundër tërbimit dhe sëmundjeve, sterilizimi gjegjësisht kastrimin, ushqimin për 10 ditë dhe lëshimin në vendin ku janë marrë). Një kërkesë e pat që të mirëmbahet rruga deri te objekti e që gjatë dimrit është tejet e vështirë dhe e pa kalueshme, por e pat një ofertë për vaksinimin kundër tërbimit pa pagesë.

Ndriqimi publik

Kryesisht funksionon mirë përveç disa vërejtjeve si psh në Ratkoc, ku u tha se të shumtën e kohës janë të dëmtuara llambat përgjatë shtratit të rregulluar te lumit, Në Apterushë mirëmbajtjen deri vone e kanë bërë vet banorët e fshatit, ndërsa tani gjendja është e mire. E njëjta dukuri ka qenë edhe në Zaqisht, Celinë etj. Tani ka filluar edhe faza tjetër për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, si psh. Në Fortesë që është afër përfundimit, do të vazhdoj në Xërxë, Krushë etj. Si dhe mirëmbajtja tani është shumë më e mire nga operatori që e ka fituar tenderin. Në fund gjatë vizitave nëpër disa fshatra i kemi evidencuar disa shqetësime ose kërkesa të rëndësishme

- Ne Kaznik urgjentisht duhet të intervenohet me zhavorr në rrugën që shpie deri te lagja Isakaj e cila është në gjendje të mjerueshme dhe sidomos dimrit mezi arrihet deri te shtëpitë e lagjes. Njëjtë qëndron puna edhe me rrugën për te varrezat e fshatit për çka kërkohet vetëm një shtresë zhavorr dhe asgjë më tepër sepse mezi arrihet në varreza.
 - Në Guri të kuq, Palluzhë, Kaznik, Pastasel dhe disa lagje të Kramovikut, energjia elektrike është aq e dobët sa që jo vetëm që duhet përforcues për cdo pajisje por psh. në shkollën e Gurit të kuq as llambat e neonit nëpër klasë nuk ndizen prej tensionit të ulët. Edhe në Qifllak rrjeti është i vjetruar dhe nuk i plotëson nevojat aktuale.
 - Në Xërxë, shqetësim të madh paraqet udhëkryqi kryesor ku nuk ka as shenjëzim horizontal as vertikal dhe më së shumti janë të rrezikuar nxënësit e fshatit.
 - Në Mrasor kanë një kërkesë për rrethojë të oborrit të shkollës rreth 200 m, si dhe vendosjen e tabelës me emrin e në hyrje të fshatit.
 - Njëjtë edhe në Senovc kërkojnë rrethimin e fushës së sportit të shkollës me rrjetë metalike, sepse nxënësit janë të rrezikuar prej rrugës kryesore që kalon afër fushës së sportit.
 - Në Dejn kërkojnë që të rregullohet me zhavorr një rrugë rreth 350m, deri te vendi që e ka propozuar edhe KFOR-i për ti hedhur mbeturinat e ngurta sepse të gjitha hedhen në Dri.
 - Një kërkesë është nga Apterusha por që vlen për te gjithë komunën që sa më shpesh të dalin inspektorët në teren që të parandalohet hedhja e mbeturinave sidomos të atyre familjeve që nuk janë kyçur në kompaninë e mbeturinave.
 - Në Brestovc janë të shqetësuar për mungesën e trotuarit gjatë rrugës magjistrale të lagjes periferike në drejtim të Rahovecit e që më së shumti janë të rrezikuar nxënësit e shkollës.
 - Në Nagavc kërkojmë që së paku pjesa e shtratit të lumit të cilën e kemi rregulluar me vetiniciativë (e që nuk është më e gjatë se 100 m), të pastrohet dy herë gjatë vitit sepse vazhdimisht mbushet me rërë dhe mbeturina, e që e bën të pa vlerë edhe investimin që e kemi bërë për rregullimin e shtratit të lumit.
- Gjithashtu gjendja e oborrit të shkollës në Nagavc është e mjerueshme dhe nuk kanë as ku te rreshtohen nxënësit as ku të luajnë, ndërsa kur ka të reshura oborri shndërrohet në liqen.
- Ka edhe shumë kërkesa tjera e sidomos për rregullimin e rrugëve fushore, si dhe kërkesa që tanimë veç janë të përfshirë në buxhetin e vitit 2017 e që nuk e pash të arsyeshme ti ceku, por këto ishin më të rëndësishme dhe besoj se do të hasin në mirëkuptim të drejtorive përkatëse.

Tani më poshtë do të përshkruajmë gjendjen në lokalitetet që I kam vizituar pas raportimit të parë duke filluar nga lagjet e qytetit të Rahovecit.

RAHOVECI (Lagjet nr.1, 2, 3, 4 dhe 5)

Lagjia Nr.1

Furnizimi me ujë të pijes – Furnizimi është në rregull dhe nuk ka problem në këtë aspekt.

Rrjeti i Kanalizimit – Në rrugën Mexhit Mustafa ende ka familje me gropa septike, për shkak të problemeve pronësore.

Mbeturinat – Mbeturinat familjare janë në rregull, por problem paraqesin mbeturinat e ngurta të cilat i hedhin në dalje te rruga Gëzim Hamza.

Ndriçimi publik – Mirëmbajtja nuk është në rregull sidomos prej trekëndëshit (lidhja me rrugën Sheh Myhedini) deri te palestra sportive.

Infrastruktura rrugore – Këtë mandat është kubëzuar vetëm rruga te familja Shehu-degë e rrugës Mexhit Mustafa.

Ka nevojë për vazhdimin e rregullimit të kësaj rruge deri te podrumi i Selami Shehut, si dhe disa rugica më të shkurta.

Shqetësimet kryesore të kësaj lagje:

-Muri mbrojtës te varrezat – përballë Al - Petrol-it që paraqet rrezik permanent për çdo qytetar-kalimtar.

-Shtyllat elektrike të drurit të cilat janë shumë të vjetra dhe të dëmtuara e të cilat duhet urgjent të ndërrohen.

Lagjia Nr.2 (qendra)

Furnizimi me ujë të pijes – kryesisht gjendja është e kënaqshme.

Rrjeti i Kanalizimit – Rrjeti funksionon mirë dhe çdo gjë është në rregull.

Infrastruktura rrugore – Është e mirë por problem është se pas rregullimit të kanalizimit në rrugën (Sheh Myhedini) te trekëndëshi nuk është rregulluar si duhet (ka fjetur), njëjtë edhe rruga që lëshohet teposhtë drejt tregut.

Ndriçimi publik- mirë është por ka nevojë edhe te lagjia Vuçitërna (disa rugica).

Mbeturinat – Me kompaninë që e bën grumbullimin, janë të kënaqur me shërbimin e ofruar.

Shqetësime - shqetësimet më të mëdha janë:

- Rreth banesave kolektive në qendër-si psh. Rreziku nga rrënja e tullave nga kati i epërm.

- Kulmet e ndërtesave po pikojnë, sidomos aty ku ka qenë BPB ka ankesa.

-Në rrethin te qendra shumë herë pengohet lëvizja e lirë për shkak të parkimit të veturave si dhe shitjes në rrugë.

- Te shkolla Bekim Sylka ka nevojë policë të shtrirë për shkak të lëvizjes së nxënësve, të cilët rrezikohen nga lëvizja e makinave.

- Mos mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta publike – konkretisht rrethi në qendër dhe mini parku te BIK-u.

- Ndërrimi urgjent i shtyllave elektrike të drurit sepse paraqesin rrezik permanent për qytetarët.

Lagjia Nr.3

Furnizimi me ujë të pijes – Ende ka reduktime por në krahasim me vitet e kaluara gjendja është shumë më e kënaqshme.

Rrjeti i Kanalizimit – është në rregull

Infrastruktura rrugore – Ka nevojë që të rregullohet rruga Mizair Isma që lëshohet majtas rrugës që shkon për Drenovc

Ndriçimi publik- Nuk mirëmbahet me rregull – mungojnë shumë llamba.

Mbeturinat - kompania i mbledh mbeturinat me rregull.

Shqetësimet - shqetësimet më të mëdha janë:

-Mungesa edhe e një trafoje së paku -rryma elektrike është shumë e dobët dhe duhet patjetër edhe një trafo të vendoset në këtë lagje.

-Ambulanca – Në këtë lagje është e nevojshme ndërtimi i një ambulante sepse shumë banorë janë të varfër dhe të vetmin mjet e kanë nga një moto kultivator, prandaj rastet emergjente paraqesin shqetësim për këta banorë.

Lagjia Nr.4

Furnizimi me ujë të pijes – kryesisht është gjendja e kënaqshme.

Rrjeti i Kanalizimit – është në rregull

Infrastruktura rrugore – Rruga Xhafer Nurkasa është deformuar shumë dhe duhet intervenim sa më shpejtë. Edhe një rrugë duhet kubëzuar sepse është pa kubëzuar.

Ndriçimi publik- funksionon mirë dhe mirëmbahet me rregull.

Mbeturinat – Të kënaqur me kompaninë e cila i mbledh mbeturinat.

Shqetësimet - shqetësimet më të mëdha janë:

-Duhet të vendosen policë të shtrirë në rrugën Asllan Kleçka, si dhe në rrugën Avdullah Bugari prej shkollës Isa Boletini e deri mbi ambulante.

-Te shkolla Isa Boletini duhet gjetur një zgjidhje për lëvizjen e nxënësve por edhe të qytetarëve (psh. nënkallim)

- Ndërrimi urgjent i shtyllave elektrike të drurit sepse paraqesin rrezik permanent për qytetarët.

Lagjia Nr.5

Furnizimi me ujë të pijes – kryesisht është gjendja e kënaqshme.

Rrjeti i Kanalizimit – është në rregull.

Infrastruktura rrugore – Është punuar mjaft, por ka nevojë edhe disa rrugica të rregullohen me kubëza.

Ndriçimi publik- Që tre muaj mirë është duke u mirëmbajtur. Ka nevojë për ndriçim edhe rruga Edit Durham dhe Bedredin Shehu.

Mbeturinat – kompania i mbledh mbeturinat me rregull.

Shqetësimet - shqetësimet më të mëdha janë:

-Mungesa edhe e një trafoje së paku - sepse e tërë lagjja është vetëm me dy trafo dhe rryma është shumë e dobët.

-Problemi i ujërave atmosferik – Shtrati i lumit Rimnik është ngushtuar shumë, dhe disa ura private e kanë kufizuar rrjedhën e ujit e i cili po del mbi asfalt në rrugën magjistrale.

-Te rrethi në hyrje të qytetit – mungon trotuari në gjatësinë rreth 30m në pjesën e rrethit që e lidh rrugën UÇK dhe rrugën Xhelal Hajda, e që paraqet rrezik të madh sepse nuk kanë kah të ecin këmbësorët.

Fortesa

Furnizimi me ujë të pijes – Furnizimi dhe mirëmbajtja e rrjetit është në rregull.

Rrjeti i kanalizimit – Disa shtëpi të lagjes Gashi ende nuk janë të kyqura ende.

Mbeturinat – mbledhja bëhet me rregull.

Ndriçimi publik – tani është duke u instaluar.

Infrastruktura rrugore- Shumica janë kryer dhe disa janë duke u kryer.

Shqetësimet:

-Rrugët fushore

-Lumi Rimnik – duhet prej daljes së fshatit me u thellua në mënyrë që ta tërheqë sasinë e ujit më mirë.

-Shtyllat elektrike të vjetruara duhet ndërruar sa më pare.

-Renovimi i shkollës.

Pataqani i Poshtëm

Furnizimi me ujë të pijes – kryesisht është gjendja e kënaqshme, përveç gjatë stinës së verës për shkak të keqpërdorimit të ujit për ujitje.

Rrjeti i Kanalizimit – Pjesa e ndërtuar është në rregull, por ka mbetur pa u ndërtuar edhe në 20% të fshatit.

Ujërat atmosferike – Ka nevojë për rregullimin e shtratit të lumit sepse pjesa e poshtme e fshatit janë të rrezikuar nga lumi kur ka reshje të rrëmbyeshme.

Infrastruktura rrugore – Është punuar mjaft, dhe shumica e fshatit është e kyçur në rrugë të ndërtuara.

Mbeturinat – Kompania i mbledh mbeturinat me rregull, por shumë familje janë të papërgjegjshme dhe nuk kyçen e nuk paguajnë.

Shqetësimet -

-Mungesa e trotuarit deri te shkolla për shkak të rrezikimit të nxënësve gjatë shkuarje-ardhjes në shkollë.

Pataqani i Epërm

Furnizimi me ujë të pijes –gjendja është e kënaqshme.

Rrjeti i Kanalizimit – Rreth 50% e fshatit ende nuk është e mbuluar me rrjet të kanalizimit.

Problem paraqet edhe derdhja e kanalizimit në fusha të hapura, çka e dëmton edhe ambientin edhe pronat bujqësore. Problem tjetër është se edhe aty ku ka kanalizim nuk ka mirëmbajtje dhe ka defekte të shumta, bllokim të kanalizimit, të pusetave, mungesa e kapakëve të pusetave etj.

Infrastruktura rrugore – Shumica e fshatit është e kyçur në rrugë të ndërtuara.

Mbeturinat – Kompania i mbledh mbeturinat me rregull.

Shqetësimet -

-Mungesa e trotuarit deri te shkolla për shkak të rrezikimit të nxënësve gjatë shkuarje-ardhjes në shkollë, si dhe nevoja për montimin e policëve të shtrirë për ngadalësim të shpejtësisë.

-Mungesa e një rruge që e lidh lagjen Sakip Bellaqa me qendrën e fshatit, së paku të shtruar me zhavorr për shkak se nxënësit janë të detyruar të kalojnë nëpër ara dhe lëndina për të shkuar në shkollë.

-Rryma elektrike në fshat është në gjendje katastrofale sepse ende është rrjeti I viteve 70-ta dhe sa herë ka të reshura, ka edhe ndërprerje të rrymës për shkak të rrjetit të dobët dhe shtyllave të vjetruara dhe të dëmtuara.

-Rrugët fushore gjithashtu paraqesin problem të madh.

Nashpallë

Furnizimi me ujë të pijes –gjendja është e kënaqshme, përveç stinës së verës kur bie shtypja shumë.

Rrjeti i Kanalizimit – Shumica e fshatit janë të kyçur në rrjetin e kanalizimit, përveç 4-5 familjeve
Infrastruktura rrugore – Dy rrugët kryesore të fshatit janë të ndërtuara, kanë mbetur edhe disa rrugica të shkurta.

Mbeturinat – Kompania i mbledh mbeturinat me rregull.

Shqetësimet -

-Mos mirëmbajtja dimërore e rrugës kryesore në dalje të fshatit që paraqet problem të vazhdueshëm gjatë stinës së dimrit.

-Shtyllat e vjetruara të rrjetit elektrik.

-Mungesa e trotuarit deri te shkolla për shkak se nxënësit janë shumë të rrezikuar.

-Rregullimi së paku me zhavor i rrugës së varrezave.

Shqetësimet që vazhdojnë edhe më tutje në fshatrat që nuk janë të përmendura në këtë raport:

-Problem i mbulimit të rrugës me gurë dhe baltë kur ka të reshura, dhe mospastrimi me kohë në fshatrat Drenoc, Senoc dhe Pastasel.

-Problemi i mungesës së ujit të pijes në Fshatrat Mrasor, Guri i kuq, Palluzhë, Kaznik, Pastasel, si dhe mungesa e ujit të mjaftueshëm në Drenoc.

-Nevoja e renovimit të shkollës në Qifllak, Fortesë, Nagavc (kompletimi I objektit) dhe shumë fshatra tjera.

-Problemi me ujërat atmosferike në fshatrat Qifllak, Dabidol, Malësi e vogël, Gexhe dhe Celinë, në të cilat fshatra duhet urgjent të pastrohen dhe të zgjerohen kanalet për kullimin e tokave të cilat gjatë kohës së reshjeve atmosferike shndërrohen në liqeje.

-Mirëmbajtja e hapësirave të hapura publike nuk është në nivel edhe pse në sipërfaqe të vogël.

-Mungesa e gropave septike në dalje të shumë fshatrave, pasi ende mungojnë kolektorët kryesorë.

-Nevoja për pastrimin e shtratit të lumenjve (përrockave) në shumë fshatra.

-Nevoja për rregullimin e memorialit të dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Nagavc e cila është në gjendje të mjerueshme.

-Nevoja për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik edhe në pothuajse të gjitha lokalitetet e komunës sidomos aty ku ka frekuentim më të madh të njerëzve e në veçanti të nxënësve.

-Rregullimi i rrugëve fushore pothuajse në të gjitha fshatrat e komunës.

-Problem i shumicës së lokaliteteve, duke përfshirë edhe vet qendrën e qytetit (e që paraqet rrezik permanent) është dëmtimi i shtyllave elektrike të drurit, të cilat janë të vjetra me mbi 40 vite e ku komuna do të duhej shtuar presionin sa është e mundur te kompania KEDS që sa më parë të bëjë zëvendësimin e shtyllave të drurit me ato të betonit.

Mbesim me shpresë se preokupimet dhe shqetësimet e qytetarëve të Komunës së Rahovecit do të gjejnë mbështetjen e nevojshme nga Drejtoritë përkatëse, dhe në kohën e duhur.

Rahovec,

Data, 20.04.2017

Kryesuesi i KLSH.P.-së
Hysni Gëlleci

